



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E FINANCËVE DHE EKONOMISË
AGJENCIA KOMBËTARE E PUNËSIMIT DHE AFTËSIVE
SHKOLLA E MESME TEKNIKE PROFESIONALE "DEMIR PROGRI" KORÇË

Nr. 143 Prot.

Korçë, më 22/09/2021

Lënda: Njoftim për levizje paralele.

DREJTORISE SE SHERBIMEVE MBESHTETËSE
DREJTORISE SE MARREDHENIEVE ME PUBLIKUN
AGJENCISE KOMBETARE TE PUNESIMIT DHE AFTESIVE

Në zbatim të ligjit nr.15/2019, "Për nxitjen e punësimit"; të ligjit nr. 15/2017, "Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë"; të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.554, datë 31.07.2019, "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të Agjencisë Kombëtare të punësimit dhe aftësive"; të udhëzimit nr.14, datë 27.05.2021, "Për mënyrën e organizimit dhe veprimtarinë e ofruesve publikë të arsimit dhe formimit profesional",

Ofruesi publik i AFP-së shkolla e mesme teknike profesionale "Demir Progri" Korçë, ju njofton krijimin e vendit të lirë me lëvizje paralele për pozicionin:

- 1 Mësimdhënës i praktikës profesionale në drejtimin Mekanikë me kohë të pjesshme.

1. Kriteret e përgjithshme dhe kriteret e posaçme.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e përgjithshme për lëvizjen paralele si vijon:

- a) Të ketë zotësi të plotë për të vepruar;
- b) Të jetë në kushte shëndetsore që e lejojnë të kryejë detyrën;
- c) Të mos jetë i dënuar me vendim të formës së prerë për kryerjen e veprave penale;
- d) Të mos ketë ndaj tij masa disiplinore që nuk janë shuar;
- e) Të demonstrojë vlera të larta të etikës, sjelljes dhe komunikimit;
- f) Të demonstrojë aftësi të punës në grup dhe të motivimit.

Aplikanti duhet të plotësojë kriteret e posaçme si vijon:

- a) Të ketë të paktën diplomë nga një shkollë e mesme profesionale në të njëjtën fushë me kualifikimin profesional të ofruesit të AFP-së për të cilin po aplikon.
- b) Të ketë të paktën 3(tre) vjet përvojë pune në fushën, në të cilën ka kryer studimet.
- c) Të njohë dhe të përdorë teknologjinë e informacionit.

2. Dokumentet e aplikimit.

Dosja e aplikimit e cila përmban dokumentacionin e kërkuar, sipas njoftimit të vendit të lirë, duhet të përfshijë:

- a) Letërmotivimin për pozicionin;
- b) Jetëshkrimin (CV-në)
- c) Kartën e identitetit
- d) Diplomën
- e) Librezën e punës
- f) Çdo dokumentacion tjetër që vërteton kualifikimet, trajnimet apo të tjera të përmendura në CV.
- g) Çertifikatën ose dëshminë për nivelin e njohurive në teknologjinë e informacionit.
- h) Vërtetimin e gjendjes shëndetsore
- i) Vërtetimin e gjendjes gjyqësore.
- j) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit, që ndaj tij nuk ka marrë masë disiplinore në fuqi
- k) Një rekomandim ose vlerësim pune nga punëdhënësi të mëparshëm.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose të noterizuara;

Dokumentet në gjuhë të huaj duhet të jenë të përkthyer dhe të noterizuara.

Dokumentet e aplikimit dorëzohen në protokollin e ofruesit të AFP-së, brenda datës

05.10.2021

